



With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



KATEDRA JEAN MONNET

EEAABAC

EU ENLARGEMENT AND ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

SHKOLLA VERORE

Legjislacioni dhe institucionet e BE-së për profesionistët e së ardhmes

11 KORRIK – 15 KORRIK 2023

**EFEKTET E MARRËVESHJES SË STABILIZIM ASOCIMIT GJATË PERIUDHËS SË
PARA ANTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË BE
Prof. Asoc. Dr. Ph.D. Rezarta Tahiraj**

Departamenti i së Drejtës – UNIEL

Mbështetur në objektivin kombëtar të integritit në BE, marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Europian (BE) kanë natyrë strategjike dhe prioritare. Shprehje e politikës së jashtme të qeverisë shqiptare, anëtarësimi i shtetit shqiptar në BE përfaqëson një ndër interesat parësore të Shqipërisë në lidhje me BE.

Në një këndvështrim retrospektiv të historikut të zhvillimit të marrëdhënieve të Shqipërisë me BE evidentohet se vendosja e marrëdhënieve të Shqipërisë me BE e kanë orgjinën e tyre në vitin 1991 kur Shqipëria vendosi marrëdhëniet e saj diplomatike me Komunitetin Europian. Por, vetëm pas 9 vitesh nga data e vendosjes së marrëdhënieve me BE, pra, në vitin 2000, u bë e mundur njohja zyrtare e Shqipërisë nga BE si një vend kandidat potencial.

Në vijim, në vitin 2003, Samiti i Selanikut mundësoi miratimin e procesit të stabilizim asocimit, duke konfirmuar perspektivën e anëtarësimit në BE jo vetëm të Shqipërisë por edhe të pesë vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor (Kroacia, Maqedonia e cila sot njihet me emërtimin Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina).

Në po të njëjtin vit nisën edhe negociatat për realizimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) midis Shqipërisë dhe BE si dhe vendeve të tij anëtare.

Proçesi i negociatave midis Shqipërisë dhe BE, referuar konkretizimit të nënshkrimit të MAS për Shqipërinë, përfundon më 12 qershor të vitit 2006 me nënshkrimin e MSA në Këshillin e Çështjeve të Përgjithshme në Luksemburg.

Në 1 prill të vitit 2009 MSA e nënshkruar midis Shqipërisë dhe BE si dhe vendeve anëtare të BE hyn në fuqi dhe në po të njëjtin muaj Shqipëria formalizoi aplikimin për anëtarësimin e saj në BE.

Në nëntor të vitit 2009, bazuar në pyetësorin që Komisioni Europian (KE) i dorëzoi Shqipërisë në lidhje me përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësim, filluan dhe negociatat për fitimin e statusit të vendit kandidat.

- **Përmbushja e kësaj procedure shënon fillimin e një faze të re të marrdhënieve midis Shqipërisë dhe BE që mundëson përshpejtimin e procesit të integrimit european të Shqipërisë në BE dhe për të cilin kërkohet një menaxhim rigoroz nga institucionet e shtetit shqiptar dhe institucionet europiane.**
- **Kjo çështje e fundit përbën një ndër nënçështjet që do të analizohen në këtë leksion, krahas analizës në këndvështrimin krahasues të planeve kombëtare të integrimit european të Shqipërisë:si dhe të rolit e rëndësisë së kriterëve politike dhe ekonomike në procesin e integrimit european të Shqipërisë me qëllim mundësimin e një ekonomi tregu funksionale për Shqipërinë dhe përballjen e konkurrencës në tregun e brendshëm european.**

Integrimi European i Shqipërisë përbën një ndër objektivat më të rëndësishëm për qeverinë shqiptare si në kontekstin gjeostrategjik edhe në atë politik duke qenë thelbi i politikës së brendshme dhe të jashtme të shtetit shqiptar.

Proçesi i integrimit të Shqipërisë në BE u intensifikua, veçanërisht, në 27 qershor 2014 me vendimin e KE i cili i dha Shqipërisë statusin e vendit kandidat në BE në vlerësim të përmbushjes të disa prej reformave kyçe që kushtëzuan fitimin e këtij statusi.

Në fakt, ky vendim i KE u prapri nga nisma e Dialogut të Nivelit të Lartë midis BE dhe Shqipërisë në nëntor të vitit 2013, duke patur si qëllim kryesor fokusimin e Shqipërisë në proçesin e integrimit european dhe monitorimin e progresit të arritur në fushat e pesë prioritereve kyçe të përcaktuara për hapjen e neogociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Konkretisht, bëhet fjalë për këto pesë prioritete: 1. Reforma në administratën publike; 2. Reforma në pushtetin gjyqësor; 3. Lufta kundër korrupsionit; 4. Lufta kundër krimit të organizuar; 5. Mbrojtja e të drejtave të njeriut.

- **Por, pyetja që shtrohet është: përse ka rëndësi për Shqipërinë fitimi i statusit të vendit kandidat në BE?**
- **Fitimi i statusit të vendit kandidat në BE ka një rëndësi shumëdimensionale për Shqipërinë për këto arsye:**
 1. **Në dimensionin politik, anëtarësimi i Shqipërisë në BE është shumë i rëndësishëm pasi është tregues i vazhimit të përmbushjes së reformave të nevojshme nga shteti shqiptar pavarësisht vështirësive në përmbushjen e tyre;**
 2. **Në dimensionin ekonomik, anëtarësimi i Shqipërisë në BE do të mundësojë krijimin e një mjedisi të favorshëm për biznesin, nxitjen e investimeve të huaja dhe rritjen ekonomike të qëndrueshme për Shqipërinë;**
 3. **Në dimensionin e politikës së jashtme, anëtarësimi i Shqipërisë në BE do të forcojë më tej bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe BE si dhe institucioneve europiane;**
 4. **Në dimensionin e zgjerimit të juridiksionit të BE, anëtarësimi i Shqipërisë në BE rikonfermon se procesi i zgjerimit të BE është prioritet i BE dhe shteteve anëtare të BE edhe në referim me Shqipërinë dhe vëndet e Ballkanit Perëndimor**

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

- **Vendimi i 27 qershorit 2014 i KE u parapri, në maj të 2014, me miratimin e një udhërrëfyese nga qeveria shqiptare.**
- **Ky udhërrëfyes përcakton dhe strukturon qartë reformat e parashikuara në lidhje me përmbushjen e prioriteteteve kryesore të cilat në pjesën më të konsiderueshme të tyre rezultojnë se janë konkretizuar. Pas publikimit nga KE, në maj 2015, të raportit progresit për Shqipërinë, qeveria shqiptare përgatiti një plan veprimi lidhur me përmbushjen e rekomandimeve afatshkurtra të përcaktuara nga ky raport, monitorimi i të cilit po realizohet nga Bordi i Integritetit Europian si një ndër organet e qeverisë shqiptare i krijuar për monitorimin dhe mbështetjen e procesit të integritetit europian të Shqipërisë.**
- **Të gjitha zhvillimet e trajtuara sa më sipër janë pasojë e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit (MSA) që BE dhe shtetet anëtare nënshkruan me Shqipërinë e cila hyri në fuqi në 1 prill 2009, në vijim të vënies në zbatim të procesit të stabilizimit asocimit për pesë shtetet e Ballkanit Perëndimor (Kroacia, Maqedonia e cila sot njihet me emërtimin Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina) shpallur nga BE në vitin 2000 në Samitin e Zagrebit.**

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

- **Neni 1 i MSA përcakton shprehimisht se “BE mbështet përpjekjet e Shqipërisë: - për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; - për të kontribuar në stabilitetin politik, ekonomik e institucional në Shqipëri si dhe për stabilizimin e rajonit; - të sigurojë një strukturë të përshtatshme për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve; - të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, gjithashtu edhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Komunitetit European; - të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për të përfunduar tranzicionin në një ekonomi tregu funksionale, - të nxisë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Komunitetit European dhe Shqipërisë; - të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat që mbulon Marrëveshja e Stabilizim Asocimit.**

- **MSA e detyron Shqipërinë të respektojë parimet e përgjithshme të demokracisë dhe të drejtat e njeriut të përcaktuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit për një Europë të Re.**
- **Përveç kësaj, Shqipëria angazhohet të vazhdojë dhe të nxisë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë një nivel të përshtatshëm lëshimesh të ndërsjella në lidhje me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, veçanërisht, projektet që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit, trafikimin e qenieve njerëzore dhe tregtinë e drogë**

Ky angazhim përbën një faktor kyç në zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit midis Palëve sepse kontribuon në stabilitetin rajonal e bashkëpunimin e qëndrueshëm midis Shqipërisë dhe BE.

Krahas angazhimeve të trajtuara sa më sipër, MSA përcakton në nenin 70 edhe një angazhim të veçantë për shtetin shqiptar: detyrimin e Shqipërisë për të përafruar legjislacionin e brendshëm me legjislacionin e BE i cili do të mundësojë rritjen e zhvillimit ekonomik dhe tregtinë me BE, përmirësimin e mirëqënies dhe kushteve të jetesës së popullit shqiptar, duke u finalizuar me anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Ndër të tjera, ke nen përcakton se procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë europian, konceptuar në dy faza me shtrirje 5 vjeçare për secilën prej tyre, duhet të përfundojë brenda vitit 2019.

Konstatohet se, nga momenti i fitimit të statusit të vendit kandidat në BE, qeveria shqiptare intensifikoi veprimtarinë e saj në drejtim të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në MSA për integrimin e Shqipërisë në BE. Bazuar në arritjet për 5 prioritetet kyçe, KE më 9 nëntor 2016 i propozoi për herë të parë Këshillit European fillimin e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë, në varësi të një progresi konkret në zbatimin e reformës në drejtësi, në vecati të “Vettingut” të qyrtarëve dhe prokurorëve

- **Më 17 prill 2018, KE, në paketën e vjetore të zgjerimit, rekomandoi që Këshilli European të vendosë që negociatat e anëtarësimit të hapen me Shqipërinë nën dritën e përparimit të shënuar, ruajtjes dhe thellimit të reformave nga Shqipëria. Më 26 qershor 2018, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE pranoi t'i përgjigjet pozitivisht progresit të bërë nga Shqipëria dhe të përcaktojë rrugën drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit në qershor 2019.**
- **Më 29 maj 2019 KE prezantoi paketën vjetore të zgjerimit, duke rekomanduar sërish hapjen e menjëhershme të negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë, vlerësuar se më 18 qershor 2018 Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme riafirmoi konkluzionet e tij të 26 qershorit 2018, duke njohur rekomandimin pozitiv të KE për hapjen e negociatave dhe vendosi të marrë një vendim të qartë dhe substancial për këtë jo më vonë se në tetor 2019.**
- **Më 18 tetor 2019, KE mori në shqyrtim hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë, ndërkohë që Këshilli Evropian vendosi t'i rikthehej kësaj çështjeje përpara majit 2020. Më 25 mars 2020, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë, duke marrë parasysh progresin e arritur në reformat dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara në unanimitet nga Këshilli Evropian i qershorit 2018.**

- **Më 26 mars 2020, KE miratoi vendimin e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së për hapjen e negociatave me Shqipërinë. Ky vendim vijon më pas me ardhjen e rezultatit të shumëpritur prej vitesh nga BE: hapjen, më 19 korrik të vitit 2022, të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.**
- **Hapja e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE shënon fillimin e fazës së dytë të integritit evropian: përgatitjen e anëtarësimit të Shqipërisë në BE si dhe konkretizimin e përthithjes të të drejtës evropiane, e njohur ndryshe me termin *acquis communautaire*, në sistemin juridik shqiptar si dhe përgatitjen për zbatimin e të drejtës evropiane dhe reformave ligjore, politike, ekonomike, administrative si dhe të reformave të tjera të nevojshme për anëtarësim në BE.**

Bibliografi, materiale, dokumenta zyrtare dhe linke për konsultim të mëtejshëm mbi leksionin e sotëm (Reader)

- Bibliografi

Stabilisation and Association Agreement between the European Communities and their Member States, of the one part, and the Republic of Albania, of the other part, Official Journal of the European Union L 104 (24/04/2009), L 300 (31/10/2006), L 107 (28/04/2009), <https://www.consilium.europa.eu/en/documents-publications/treaties-agreements/agreement/?id=2006040>,

Council of the European Union, Council conclusions on Albania. General Affairs Council meeting, Luxembourg, 24 June 2014, <https://www.consilium.europa.eu/media/21900/143354.pdf>,

Council of the European Union, Enlargement and Stabilisation and Association Process. Council conclusions, ELARG 41 COWEB 102, Brussels 26 June 2018, <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10555-2018-INIT/en/pdf>

Bibliografi, materiale, dokumenta zyrtare dhe linke për konsultim të mëtejshëm mbi leksionin e sotëm (Reader)

- Bibliografi

European Council, European Council 26/27 June 2014 Conclusions, EUCO 79/14, Brussels, 27 June 2014, <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-79-2014-INIT/en/pdf>

Consiglio dell'Unione Europea, Allargamento e Processo di Stabilizzazione e di Associazione Repubblica di Macedonia del Nord e Repubblica d'Albania. Conclusioni del Consiglio, ELARG 20 COWEB 35, Bruxelles 26 marzo 2020, <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/it/pdf>,

European Commission, Commission Staff Working Document Albania 2020 Report Accompanying the Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2020



Kontakt:

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Faleminderit për vëmendjen!

Pyetje?

Assoc. Prof. Dr. Ph.D. Rezarta Tahiraj

Professor of EU Tax LAW - Department of Law
Faculty of Economy
University of Elbasan

rezarta.tahiraj@uniel.edu.al



Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES